VENDIM
Nr.145, datë 7.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 20, 21 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.78, datë 26.6.2008 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a., për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë, për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Tarifa e energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012–2014) do të jetë 2.83 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani